

TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA NË PRISHTINË, PODUJEVË DHE MITROVICË PËRMES IMPIANTEVE: KU JANË SFIDAT?

Analizë e shkurtër

Shtator 2025



Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i Institutit Demokratik të
Kosovës është mbështetja e zhvillimit
të demokracisë pjesëmarrëse dhe
luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë.

COPYRIGHT © 2025. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo koment, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara.

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10 000, Prishtina, Kosova.
Tel.: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Dizajni: **envinion**

Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit “Promovimi i Aktivizmit të Gjelbër Komunitar”, dhe mbështetet nga UNDEF.

Autore kryesor: Selville Kurti

Bashkëautor: Ardian Mucaj

PËRMBAJTJA

Trajtimi i ujërave të ndotura në Prishtinë, Podujevë dhe Mitrovicë përmes impianteve: Ku janë sfidat?	01
Lista e shkurtesave	06
Rreth Analizës së shkurtër	07
Metodologjia	08
Hyrje	09
Gjendja aktuale e trajtimit të ujërave të ndotura në Kosovë	11
Ku qëndron procesi i ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në Mitrovicë, Prishtinë dhe Podujevë?	14
Projekti: Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotur në Prishtinë	17
Projekti: Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotur në Mitrovicë	19
Projekti: Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotur në Podujevë	21
Si kontribuon analiza e KDI-së në përmbushjen e obligimeve nga MSA dhe Agjenda e Gjelbër	23
Gjetjet e përgjithshme dhe specifike për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Mitrovicë, Prishtinë dhe Podujevë	24
Rekomandimet e përgjithshme	25
Rekomandimet specifike për impiantin në Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë	26

LISTA E SHKURTESAVE

BERZH / EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI / EIB	Banka Evropiane për Investime
WBIF	Korniza Investive për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework)
SECO	Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës
ARRU	Autoriteti Rregullativ i Ujërave
AMMK / AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ME	Ministria e Ekonomisë
MF	Ministria e Financave
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjiellit
PKVM	Plani Kombëtar për Veprim Mjedisor
BE	Bashkimi Evropian
Acquis	Acquis communautaire – legjislacioni i përbashkët i BE-së
SSHU	Strategjisë Shtetërore për Ujëra
ITUN	Implant për Trajtimin e Ujërave të Ndotura
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ARPL	Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore dhe Resurseve Ujore

RRETH ANALIZËS SË SHKURTËR

Qëllimi i kësaj analize të shkurtër është të paraqesë gjendjen reale të trajtimit të ujërave të ndotura dhe ecurinë e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura në Prishtinë, Mitrovicë dhe Podujevë.

Arsyeja pse KDI e trajton çështjen e ujërave të ndotura është se kjo temë lidhet drejtpërdrejt me misionin e organizatës për të forcuar llogaridhënien publike, transparencën në menaxhimin e fondeve publike, si dhe përfshirjen qytetare në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në mjedis dhe në jetën e përditshme të njerëzve.

Trajtimi i ujërave të ndotura përbën gjithashtu një fushë kyçe të përpjekjeve të Kosovës për t'u përafëruar me Agjëndën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe me

acquis communautaire të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e ujërave, i cili kërkon funksionalizimin e sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotur si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të cilësisë së jetesës.

Përmes shpalosjes së fakteve dhe të gjeturave, analiza synon të sjellë në vëmendjen institucionale e shoqërore nevojën që trajtimi i ujërave të ndotura të konsiderohet prioritet. Për më tepër, kërkon që të thirrë në llogari institucionet publike dhe akterët përgjegjëse për zvarritjet dhe moszbatimin e politikave, përkatësisht masave buxhetore që përkrahin ndërtimin e impianteve të reja, si parakusht për përmirësimin e gjendjes alarmante të lumenjve të Kosovës.

METODOLOGJIA

Për hartimin e kësaj analize janë shqyrtuar dokumente publike si: Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat në Republikën e Kosovës, Strategjia e Ujërave 2017 – 2036, dokumenti i Rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025, projekt-buxheti për vitin 2025, të dhënat statistikore nga Raportet e gjendjes së mjedisit nga AMMK, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën (2024) dhe informata të tjera nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e ujërave të ndotura.

Për të plotësuar informatat bazë nga hulumtimi i dokumenteve publike, KDI ka realizuar intervista dhe konsultime me përfaqësues të institucioneve relevante, si nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit Rajonal “Prishtina”, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Ekonomisë (ME), Autoriteti Rregullativ i Ujërave (ARRU) dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK).

Disa informata janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare të adresuara në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Financave, si dhe kërkesë për qasje në informatë në KRU “Mitrovica”, KRU “Prishtina”, dhe në Komunën e Mitrovicës.

Në kuadër të hulumtimit janë zhvilluar edhe vizita në teren për të parë nga afër se si funksionojnë impiantet pranë KRU “Gjakova”, KRU “Hidrodrini” dhe KRU “Hirdoregjioni Jugor”, si dhe është komunikuar me aktorë të tjerë të përfshirë në menaxhimin dhe implementimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.


Analiza mbulon periudhën korrik–shtator 2025, duke ofruar një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse mbi gjendjen aktuale të trajtimit të ujërave të ndotur me fokus ndërtimin e Impianteve në Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë.

HYRJJE

Ndërtimi i impianteve është pjesë e Strategjisë Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017–2036¹ (shih tabelën 1) dhe objektivave të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, dhe ka për synim eliminimin e ndotjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit në vend.

Ligji Nr. 04/L-14²⁷ për Ujërat në Republikën e Kosovës e vendosë qartë ujin si pasuri me interes të përgjithshëm, duke përcaktuar objektiva për shfrytëzim të qëndrueshëm të tij, mbrojtje nga ndotja dhe menaxhim në funksion të shëndetit publik, mjedisit dhe zhvillimit socio-ekonomik.

Megjithatë, nga të dhënat e fundit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), del se vetëm 11%³ e ujërave të ndotura në Kosovë trajtohen përmes impianteve funksionale. Bazuar në këtë të dhënë, pjesa e mbetur, rreth 89% e ujërave të zeza derdhet drejtpërdrejt në lumenj pa asnjë trajtim, duke shkaktuar ndotje të vazhdueshme, degradim të ekosistemeve ujore dhe ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve.



1 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017–2036. Prishtinë, 5 maj 2017. E qasshme online: https://mjedisi.info/ep-content/uploads/2023/03/National-water-management-strategy-2036-Kosovo.pdf?utm_source=chatgpt.com

2 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Republikës së Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10, 14 maj 2013. E qasshme online: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860>

3 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Raporti i gjendjes së mjedisit 2022 (drafti final), Prishtinë: AMMK, publikuar në korrik 2023, fq. 101. [Online](#)

Kjo gjetje, e nxjerrë nga analiza e KDI-së bazuar në të dhënat e AMMK-së, tregon se pavarësisht se trajtimi i ujërave të ndotura përbën një ndër komponentët më të rëndësishëm të politikave mjedisore dhe të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, Kosova vazhdon të përballet me mungesë infrastrukture dhe kapacitete të mjaftueshme institucionale për trajtimin e ujërave të ndotur.

Në këtë kuadër, Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor ‘përfaqëson një instrument politik kyç përmes të cilit shtetet e rajonit, përfshirë Kosovën, janë zotuar për masa konkrete drejt tranzicionit të qëndrueshëm mjedisor. Kjo agjendë e rendit trajtimin e ujërave të ndotura si një ndër fushat prioritare nëpërmjet tri shtyllave themelore: eliminimi i ndotjes, mbrojtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i ekonomisë qarkore.

I Tabela 1 – Strategjia e Ujërave të Kosovës 2017 – 2036

Strategjia e Ujërave të Kosovës 2017 – 2036

Tabela 5 - Investimet me prioritet të lartë dhe kosto të lartë për sektorin e ujërave: PKVM

1. Kanalizimi	Ndërtimi i infrastrukturës për impiante të mëdha të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUZ) në 7 qendra kryesore: përafërsisht 900 000 p.e.	MMPH MZHE PSP Komunat	€136 mln	60% donatoret 40% BK
---------------	--	--------------------------------	----------	----------------------------

Këto shtylla synojnë nxitjen e veprimeve për reduktimin e ndotjes dhe ripërdorimin e resurseve ujore, duke vënë në pah nevojën për sisteme efikase dhe gjithëpërfshirëse të trajtimit. Në vlerësim e sipër, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën (2024) ⁵vlerëson se progresi në fushën e menaxhimit të ujërave mbetet i kufizuar.

Progresi i kufizuar tregon se Kosova vazhdon të përballet me sfida të mëdha në menaxhimin e burimeve ujore. Këto sfida përvec kompletimit të kornizës ligjore, lidhet edhe me planifikimin, sigurimin e financimit për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, përmirësimin e rrjeteve të kolektorëve dhe ngritjen e impianteve të reja për trajtimin e ujërave të ndotura.

4 Komisioni Evropian, Dokument Udhëzues i Stafit – Udhëzime për Zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (2020), Bruksel, 6 tetor 2020, f. 3. E qasshme online: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0223>

5 Komisioni Evropian – Raporti për Kosovën 2024, Bruksel, 30 tetor 2024, E qasshme online: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo+Report+2024.pdf

GJENDJA AKTUALE E TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË KOSOVË

Ndërtimi i impianteve është një fushë relativisht e re për Kosovën; kjo reflektohet në progresin e ngadalshëm dhe kapacitetet e ulëta zbatuese. Procesi i trajtimit të ujërave të ndotura përfshin projektet për ndërtimin e impianteve të cilat deri më tani janë zhvilluar në mënyrë të fragmentuar, pa një qasje të integruar kombëtare dhe pa koordinim të rregullt mes autoriteteve përgjegjëse. Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura luajnë një rol qendror në mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e burimeve ujore dhe përmirësimin e shëndetit publik. Ato përfaqësojnë një nga komponentët kryesorë për përmbushjen e standardeve mjedisore të Bashkimit Evropian, përfshirë Direktivën Kornizë për Ujëra (Direktiva e BE 2000/60/EC)⁶ dhe Direktivën për Ujërat e Zeza Urbane (Direktiva e BE 2024/3019/EC)⁷, e cila kërkon trajtimin e ujërave të ndotura përpara shkarkimit të tyre në ujërat sipërfaqësore.

Në rastin e Kosovës, investimet në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura janë jetike, pasi vetëm një pjesë e kufizuar e popullsisë ka qasje në infrastrukturë

funksionale. Sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), vetëm rreth 11% e ujërave të ndotura trajtohen përmes impianteve ekzistuese. Pavarësisht investimeve në ndërtimin e impianteve të reja, kapaciteti real i shfrytëzimit të tyre mbetet i kufizuar, duke reflektuar boshllëqet në infrastrukturën e kanalizimit dhe mungesën e planifikimit të integruar.

Sipas Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 (të rishikuar), aktualisht rreth 65%⁸ e popullsisë së Kosovës është e kyçur në sisteme të kanalizimit. Kjo situatë e vështirëson ndjeshëm procesin e trajtimit të ujërave të ndotura, pasi një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ende nuk ka qasje në rrjetin e kanalizimit — i cili përbën një parakusht thelbësor për lidhjen me impiantet e trajtimit të ujërave. Për më tepër, edhe pjesa e popullsisë që është e lidhur me kanalizim nuk përfshihet plotësisht në sistemet e trajtimit, për shkak të rrjeteve të kanalizimit të fragmentuara dhe mungesës së kapaciteteve funksionale të impianteve ekzistuese.



Sipas Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 (të rishikuar), aktualisht rreth 65% e popullsisë së Kosovës është e kyçur në sisteme të kanalizimit.

6 Direktiva Kornizë për Ujëra e Bashkimit Evropian (Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 tetor 2000), e cila vendos kuadrin për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të të gjitha ujërave të sipërfaqshme dhe nëntokësore në territorin e BE-së, me synim arritjen e statusit “të mirë ekologjik dhe kimik” për të gjitha trupat ujorë. E qasshme në: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2000/60/oj/eng>

7 Direktiva e ujërave të zeza urbane e Bashkimit Evropian (Direktiva (BE) 2024/3019 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 nëntor 2024), e cila synon modernizimin e kërkesave për trajtimin e ujërave të zeza urbane në përputhje me objektivat e Tranzicionit të Gjelbër dhe neutralitetit klimatik deri në vitin 2040. E qasshme në: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/3019/oj/eng>

8 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025. Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2023. E qasshme në: [*ActDetail.aspx](#)

Si rezultat, në shumë zona rurale, ujërat e ndotura vazhdojnë të derdhen drejtpërdrejt në mjedis, duke shkaktuar ndotje të vazhdueshme dhe rrezik për shëndetin publik.

Korniza strategjike dhe rishikimi i fundit

Strategjia Shtetërore për Ujëra e Republikës së Kosovës (2017–2036), e bazuar në Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, e trajton grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura si objektiv strategjik kombëtar. Ajo parasheh realizimin përmes Planit të Veprimit dhe Investimeve për Ujëra (PVIU)⁹, me katër programe pesëvjeçare, si dhe plane për menaxhimin e pellgjeve lumore, të cilat duhet të azhurnohen periodikisht.

Megjithatë, ndryshe nga planifikimi fillestar për rishikim çdo pesë vjet, Strategjia iu nënshtrua një rishikimi të përiudhën 2023–2027¹⁰, për shkak të nevojës për të adresuar boshllëqet ligjore, institucionale dhe të zbatimit. Në rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra (SSHU) i cili është zhvilluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor kanë marrë pjesë përfaqësues nga një sërë institucione qendrore dhe akademike.

Në përbërje të ekipit kanë qenë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë (ME), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Zyra për Planifikim Strategjik dhe Zyra Ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit (ZKM). Po ashtu, në proces kanë kontribuar edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Administrimit

të Pushtetit Lokal (MAPL), Zyra e Integritimit Evropian, Ministria e Shëndetësisë (MSH), Fakulteti i Ndërtimtarisë, si dhe Shoqata e Hidroinxhinierëve të Kosovës (SHHIK). Përveç këtyre institucioneve, në hartimin e rishikimit të SSHU-së kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar edhe këshilltarët e Këshillit Ndërmintor për Ujërat (KNU) pranë Zyrës së Kryeministrit.

Objektivi specifik 3.4 i Strategjisë Shtetërore për Ujëra (SSHU) ka në fokus trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe zgjerimin e infrastrukturës për trajtimin e tyre në nivel kombëtar. Sipas kësaj Strategjie së rishikuar deri më tani, pesë komuna “Peja, Prizreni, Gjakova, Skenderaj dhe Juniku”¹¹, kanë përfunduar dhe funksionalizuar impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Në periudhën e ardhshme pesëvjeçare parashihet një aktivitet i shtuar për ndërtimin e impianteve të reja në komuna të tjera të Kosovës.

Ndër projektet kryesore është Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Rajonal për Prishtinën, i cili do të mbulojë edhe komunat e Obiliqit, Fushë Kosovës dhe Graçanicës, duke trajtuar ujërat e ndotura të rreth 400 mijë banorëve.¹² Ky projekt pritet të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe në mbrojtjen e mjedisit. Përveç këtij, është planifikuar ndërtimi i impianteve të reja për rajonet e Mitrovicës, Gjilanit, Podujevës dhe Ferizajt, si dhe përgatitja e studimeve të fizibilitetit për komunat e tjera, përfshirë Vushtrrinë, Malishevën, Drenasin, Lipjanin, Rahovecin, Therandën, Vitinë, Istogun, Deçanin, Klinën dhe Kamenicën.¹³

Në nivel operativ, impiante funksionale për trajtimin e ujërave të ndotura ekzistojnë në:



9 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017–2036. Prishtinë, 5 maj 2017. E qasshme online: https://mjedisi.info/ep-content/uploads/2023/03/National-water-management-strategy-2036-Kosovo.pdf?utm_source=chatgpt.com

10 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025. Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2023. E qasshme në: [ActDetail.aspx](#)

11 Po aty.

12 Po aty. Objektivi Specifik 3.4 – Trajtimi i ujërave të ndotura urbane, f. 33

13 Po aty.



Foto - Impianti Gjakovë, realizuar nga Selvije Kurti / KDI.

Edhe Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit - ARRU konfirmon se vetëm tri impiante më të mëdha në kapacitete të trajtimit janë funksionale dhe atë në komunën e Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit.¹⁴ Përveç tyre, janë evidentuar “13 impiante të vogla rurale në vendbanime si Harilaq, Mramor, Skivjan, Hallaq i Madh, Kramovik, Volljak, Marmull, Tërnac, Vrellë, Medvec dhe Orllan. Megjithatë, këto mbulojnë vetëm fshatra të kufizuara dhe shpesh operojnë me kapacitet minimal.”¹⁵

Synimi, sipas kësaj strategjie është përgatitja e projekteve të reja për ITUN-et rajonale, veçanërisht në:



14 Intervistë e realizuar me Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU dhe Abedin Azizi, zyrtar në ARRU, më datë 16 qershor 2025

15 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025. Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2023. E qasshme në: [ActDetail.aspx](#)

16 Po aty.

17 Genta Hodo, EBRD lends Kosovo 20 mln euro for sewerage expansion, SeeNeës, 15 dhjetor 2023. E qasshme në: <https://seenews.com/news/ebrd-lends-kosovo-20-mln-euro-for-sewerage-expansion-> (qasje më: 23 tetor 2025).

18 KRU “Bifurkacioni”. Plani i Përfshirjes së Palëve të Interesuara (SEP) – Projekti për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Ferizaj, 2024, f. 6. E qasshme në: <https://bifurkacioni.com/ep-content/uploads/2024/12/3E7F312E-644B-443A-ACC7-F0F77E44D1A1-6.pdf>

19 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është institucion i pavarur rregullator që vepron në kuadër të kuadrit ligjor për ujin dhe shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë. Kompetencat e saj janë të përcaktuara kryesisht me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit me aktet nënligjore përkatëse.

20 PROJEKT LIGJI MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/-PLmbindarjetbuxhetoreperBuxhetineKosoves2025_8TbDn5SXnY.pdf

21 Intervistë e realizuar me Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU dhe Abedin Azizi, zyrtar në ARRU, më datë 16 qershor 2025.

KU QËNDRON PROCESI I NDËRTIMIT TË IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË MITROVICË, PRISHTINË DHE PODUJEVË?

Në Projektligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, Qeveria e Kosovës ka planifikuar financimin e disa projekteve kapitale për ndëtimin e impianteve për trajtim të ujërave të ndotura, në komunën e Prishtinës, Podujevës dhe Mitrovicës. Këto projekte janë përfshirë në Programin e Investimeve Publike dhe në buxhetin e shtetit janë kategorizuar si projekte “të financuara nga fondet e huaja” për vitet 2025-2027.

Tabela 2 – Projektbuxheti i Kosovës për vitin 2025

Buxheti i Kosovës për vitin 2025
Tabela 3,2 - Projektet Kapitale për Nivelin Qendror

ORGANIZATA BUXHETORE - PROGRAMI - NËN-PROGRAMI					APROVUAR PËR VITIN 2025					VLERËSUAR PËR			
Kodi Funk	Kodi i Prop	Kodi Proj	Data e Fillimit dhe Mbarimit	Emri i Projektit	Burimet e Fin.	Shpenz deri më 2024	Vazhdim nga 2024	Të reja për 2025	Totali 2025	Vitin 2026	Vitin 2027	Vitin >2028	Vlera Totale Projektit
						1	2	3	4=2+3	5	6	7	8=1+4 +5+6+7
0520	210133-1730131	15148	02.2018-12.2025	Implanti për ujera të zeza në Komunën e Prishtinës									
					FH	0	0	0	0	0	26,124,196	0	26,124,196
0520	213165-2545919	19561	01.2025-12.2027	Implanti për Trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë									
					FH	0	0	0	0	0	6,200,000	0	6,200,000
0520	213177-2341460	19175	02.2023-12.2027	Projekti i Trajtimin të Ujërave të Zeza Mitrovicë									
					FH	0	0	0	0	0	6,700,000	0	6,700,000

Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina me rritje të vazhdueshme të popullsisë urbane vuan nga mostrajtimi i ujërave të ndotura si rezultat i mungesës së një impianti/eve funksional. Edhe Podujeva dhe Mitrovica, qytete të ndërtuara pranë rrjedhës së lumenjve Llap dhe Ibër kanë probleme të theksuara nga ndotja, poashtu janë në fazat e para të zbatimit të këtyre projekteve.

Arsyeja pse KDI, përmes kësaj analize, trajton posaçërisht këto tre impiante është se, ndonëse projektet tashmë janë pjesë e politikave buxhetore shtetërore, nuk është e qartë se në cilën fazë ndodhen në procesin e zbatimit dhe si po funksionon mbikëqyrja institucionale ndaj tyre.

Megjithatë, si ndërmarrje strategjike, impiantet mbeten një mundësi reale — dhe në shumë raste, e vetmja, për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe për të përmbushur kërkesat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e resurseve natyrore, veçanërisht lumenjve.

Prandaj, investimet në këto impiante nuk duhet të trajtohen vetëm si ndërhyrje teknike apo mjedisore, por si investime strategjike për të ardhmen, që ndikojnë drejtpërdrejt në

procesin e integritit evropian dhe në standardet e jetesës në Kosovë. Në këtë drejtim, transparenca dhe mbikëqyrja publike duhet të jenë në nivel të lartë dhe të pandërprerë, për të garantuar llogaridhënie dhe zbatim efektiv të projekteve.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, projektet për ndërtimin e tre impianteve të ujërave të ndotur kanë afate të ndryshme për përfundim. Projekti i Prishtinës është planifikuar të mbyllet më 30 qershor 2026, ai i Mitrovicës më 30 dhjetor 2026, ndërsa projekti i Podujevës ka afatin më të gjatë, duke u paraparë të përfundojë më 15 dhjetor 2031.²² Planifikimet kohore për ndërtimin e këtyre impianteve nuk përkojnë me gjendjen aktuale, meqë projektet janë ende në faza shumë të hershme. Në rastin e Prishtinës, punimet në teren nuk kanë nisur ende dhe projekti mbetet vetëm në nivel dizajnit preliminar. Në Mitrovicë, janë në fazën e përcaktimit të lokacionit për nërtim të impiantit, kurse është përzgjedhur konsulenca dhe është hartuar dizajni konceptual.²³ Ndërsa Podujeva është vetëm në hapat e parë, pasi nuk ka kontraktuar ende as konsulencë e as kontraktor për punime, duke e bërë të pamundur fillimin e zbatimit real.



Foto - Impianti në Gjakovë dhe Prizren

22 Të dhëna nga Ministria e Financave (qasje në dokumente zyrtare, 14 korrik 2025).
23 KRU Mitrovica, “Zhvillimi i Projektit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë”, e qasshme: <https://www.kru-mitrovica.com/trajtimi-i-ujerave-te-zeza/>

Kurse sipas MMPHI-së, respektivisht ARPL, ka njoftuar që deri më tani asnjë nga Kompanitë Rajonale të Ujësjetjesit që veprojnë në tri komunat përkatëse nuk ka aplikuar për t’u pajisur me lejet e nevojshme ujore, që përfshijnë edhe dokumentacionin e plotë të projektit për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Ministria sqaron se, sipas legjislacionit për ujëra dhe udhëzimeve administrative përcjellëse, aplikimi për Leje Ujore është një detyrim ligjor dhe shqyrtohet sipas kritereve të harmonizuara me Direktivën e BE-së për Ujërat e Zeza Urbane.²⁴

Sipas konfirmimit zyrtar, marrëveshjet e kredisë për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Mitrovicë dhe Prishtinë janë tashmë të ratifikuara, ndërsa për impiantin e Podujevës pritet ende ratifikimi i marrëveshjes së kredisë në Kuvend.²⁵

Në anën tjetër sa i përket mbulueshmërisë, Impianti i Prishtinës, i cili do të përfshijë komunat Prishtinë, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq, ka një kapacitet të planifikuar prej rreth 380,000 banorësh ekuivalentë. Impianti i Podujevës është i paraparë të mbulojë territorin e kësaj komune me një kapacitet prej rreth 80,000 banorësh. Ndërsa impianti i Mitrovicës, që përfshin Mitrovicën e Jugut dhe Vushtrrinë, është projektuar të mbulojë rreth 123,000 banorë ekuivalentë.

Në total, këto tri projekte parashihen të mbulojnë rreth 583,000 banorë, që përfaqëson afërsisht 34% të popullsisë së Kosovës.



Në total, këto tri projekte parashihen të mbulojnë rreth 583,000 banorë, që përfaqëson afërsisht 34% të popullsisë së Kosovës.

Tabela 3 – Të dhënat për Kapaciteti i planifikuar i mbulimit me impiante të ujërave të ndotura – Ministria e Ekonomisë (qasje në dokumente zyrtare, 15 korrik 2025)

IMPIANTI	KOMUNAT E MBULUARA	BANORËT E MBULUAR (EKUIVALENT)
Prishtinë	Prishtinë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Obiliq	380,000
Podujevë	Podujevë	80,000
Mitrovicë	Mitrovicë (Jugu) dhe Vushtrri	123,000

24 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përgjigje zyrtare ndaj kërkesës për qasje në dokumente publike lidhur me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, Divizioni për Komunikim me Publikun, 9 korrik 2025. 23 KRU Mitrovica, "Zhvillimi i Projektit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë", e qasshme: <https://www.kru-mitrovica.com/trajtimi-i-ujerave-te-zeza/>

25 Të dhëna nga Ministria e Financave (qasje në dokumente zyrtare, 14 korrik 2025).



PROJEKTI: IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR NË PRISHTINË

Impianti për trajtimin e ujërave tëndtoru a në Komunën e Prishtinës është një nga projektet më të mëdha të planifikuara në sektorin e mjedisit dhe menaxhimit të ujërave në Kosovë.

Projekti është i paraparë të realizohet me një vlerë të përgjithshme prej 165 milionë euro²⁶, e cila do të financohet nga fondet e huaja dhe është pjesë e Programit të Investimeve Publike të Qeverisë së Kosovës.

Kjo tregon se projekti vazhdon të mbetet në fazat e planifikimit ose të përgatitjes teknike, me implementimin real që pritet të ndodhë në një fazë të mëvonshme. Njësia Implementuese e Projektit është e vendosur në KRU Prishtinë.

Tabela 4 - Informata për Ndërtimin e Impiantit në Prishtinë

IMPIANTI	PRISHTINË
 Kosto totale e paraparë	165 milion €
 Struktura e financimit	Kostoja dhe struktura e financimit: Projekti parashihet të financohet përmes një kredie prej deri në 66 milion € nga DGT (Thesari Francez) dhe 20 milion € nga AFD, megjithatë, sipas vlerësimeve aktuale, 73 milion € konsiderohen të mjaftueshme për mbulimin e komponentës së kredisë. Përveç kësaj, projekti mbështetet edhe nga një grant prej 90 milion € nga ëBIF, duke e çuar investimin total në rreth 163 milion €. ²⁷
 Plani i implementimit	Ka kontraktuar konsuelcen franceze për asistencë teknike, që do të përgadisnin dokumentacion dhe dizajnin konceptual, dhe do të bëjnë mbikëqyrjen e projektit (kontrata valide deri në fund të vitit 2028). Kontraktori për ekzekutim të punimeve akoma nuk është kontraktuar. Njësia Implementuese e Projektit është e vendosur në KRU Prishtina. ²⁸
 Statusi aktual	Projekti është në fazë e dizajnit preliminar/konceptual; në zhvillim raportet mjedisore dhe socio-ekonomike.
 Data e planifikuar e përfundimit	30 qershor 2026

26 Po aty.

27 KRU Prishtina, përgjigje në kërkesë për qasje në informatë publike, data 16 korrik 2025.

28 Të dhënat për impiantet e ujërave të ndotura – Ministria e Ekonomisë (qasje në dokumente zyrtare, 15 korrik 2025)



PROJEKTI:
**IMPIANTI I
TRAJTIMIT TË
UJËRAVE TË
NDOTUR NË
MITROVICË**

Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë dhe Vushtrri është një projekt i madh infrastrukturor me një vlerë totale prej 39.3 milionë euro, i financuar përmes një bashkëpunimi shumëpalësh që përfshin Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bankën Evropiane për Investime (EIB), Kornizën Investive për Ballkanin Perëndimor (WBIF) dhe Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës (SECO).²⁹

Marrëveshja për ndërtimin e këtij impianti është nënshkruar më 21 mars 2025³⁰ dhe projekti parasheh ndërtimin e një impianti me kapacitet për 123,000 banorë ekuivalent, që do të trajtojë rreth 250 litra ujë të ndotur për sekondë nga

Mitrovica e Jugut dhe Vushtrria. Po ashtu, projekti përfshin ndërtimin dhe përmirësimin e rrjeteve të kanalizimit urban në Mitrovicë dhe atyre rurale në Vushtri, duke përfshirë ndërtimin e 50.2 km kolektorësh përgjatë lumenjve Ibër, Llushtë, Sitnicë dhe Trepça³¹, me qëllim që të eliminohet derdhja e ujërave të ndotura në lumenj dhe të sigurohet përpunimi i tyre përmes impiantit.³²

Projekti është aktualisht në fazën fillestare të implementimit, gjegjësisht në përcaktim të lokacioni. Njësia Implementuese e Projektit është e vendosur në KRU Mitrovica.

Tabela 5 - Informata për Ndërtimin e Impiantit në Prishtinë

IMPIANTI	MITROVICË
 Kosto totale e paraparë	39,337,500 €
 Struktura e financimit	Kreditë: BEI (19.8 milion €), BERZH (13.5 milion €); - Grante: ëBIF (5 milion €), BERZH (700 mijë €), SECO (337.5 mijë €)
 Plani i implementimit	Faza e definimit të lokacionit se ku do të ndërtohet impianti dhe posa të merret vendim për lokacionin, shpresohet që në fillim të vitit 2026 të hapen ftesat për tender. Dhe të vazhdohet me përfundimin e fazave të implementimit të projektit. Njësia Implementuese e Projektit është e vendosur në KRU Mitrovica dhe merret me zbatimin e projektit dhe raporton tek Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i ndërmarrjes. ³⁴
 Statusi aktual	Është përzgjedhur konsulenca e projektit, është hartuar projekti për rrjet e kanalizimit dhe koncept dizajni për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur. ³⁵ Projekti është në fazën e përcaktimit të lokacionit përfundimtar. Opsioni më i përshtatshëm, sipas rekomandimeve të konsulentit dhe dakordimit me BERZH, BEI, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe KRU Mitrovica, është lokacioni M1 (bashkimi i lumenjve Ibër dhe Sitnicë, rreth 300–400 m më në veri). Konfirmimi nga Komuna e Mitrovicës mbetet vendimtar për finalizimin e vendimit dhe fillimin e fazës së implementimit. ³⁶
 Data e planifikuar e përfundimit	30 dhjetor 2026

29 KRU Mitrovica. (11 qershor 2025). Komunikim me email mbi statusin e projektit për trajtimin e ujërave të ndotura. Dërguar tek KDI.

30 Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës. (2025, 20 janar). Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në Podujevë në vlerë prej 35 milionë euro. E qasshme: <https://me.rks-gov.net/blog/nenshkruhet-marreveshja-per-ndertimin-e-impianitit-te-ujerave-te-zeza-ne-podujeve-ne-vlere-prej-35-milione-euro>

31 Të dhëna nga Ministria e Financave (qasje në dokumente zyrtare, 14 korrik 2025).

32 Të dhënat për impiantet e ujërave të ndotura – Ministria e Ekonomisë (qasje në dokumente zyrtare, 15 korrik 2025).

33 Po aty.

34 Statusi aktual i projekteve është marrë nga Ministria e Financave (qasje në dokumente zyrtare, 16 korrik 2025)

35 Statusi aktual i projekteve është marrë nga Ministria e Ekonomisë (qasie në dokumente zyrtare, 15 korrik 2025)

36 KRU Mitrovica. (29 shtator 2025). Komunikim me email mbi përcaktimin e lokacionit për Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur.



PROJEKTI:
**IMPIANTI I
TRAJTIMIT TË
UJËRAVE TË
NDOTUR NË
PODUJEVË**

Projekti për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunën e Podujevës përbën një ndër ndërhyrjet më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës mjedisore dhe avancimin e sistemit të menaxhimit të ujërave në komunë.

Marrëveshja për ndërtimin e këtij impianti është nënshkruar më 20 janar 2025,³⁷ nga Qeveria e Kosovës, ndërsa vlera totale e investimit kap shifrën prej 34 milionë euro. Nga kjo shumë, 25 milionë euro janë siguruar përmes një kredie

nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ndërsa 10 milionë euro janë mbështetje nga Korniza Investive e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Projekti realizohet në bashkëpunim mes Qeverisë së Kosovës, BERZH-it, Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” dhe Komunës së Podujevës.³⁸

Njësia Implementuese e Projektit është e vendosur në KRU Prishtina

Tabela 6 - Informata për Ndërtimin e Impiantit në Podujevë

IMPIANTI	PODUJEVË
€ Kosto totale e paraparë	34 milion €
Struktura e financimit	- Kreditë: EBRD (25 milion €) - Grant: ëBIF (9 milion €)
Plani i implementimit	Projekti për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Podujevë – në pritje të ratifikimit të marrëveshjes së kredisë në Kuvend. Është përcaktuar lokacioni në fshatin Lupç. ³⁹ Plani dinamik do të përgatitet për të vazhduar fazat tjera. Njësia Implementuese e Projektit është e vendosur në KRU Prishtina.
Statusi aktual	Projekti është në fazën fillestare, përkatësisht në përpilim të dokumentacionit për zgjedhjen e asistencës teknike.
Data e planifikuar e përfundimit	15 dhjetor 2031

37 Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës, “Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në Podujevë në vlerë prej 35 milionë euro”, 20 janar 2025. E qasshme në: <https://me.rks-gov.net/blog/nenshkruhet-marreveshja-per-ndertimin-e-impiaantit-te-ujerave-te-zeza-ne-podujeve-ne-vlere-prej-35-milione-euro/>

38 Po aty.

39 KRU Prishtina, përgjigje në kërkesë për qasje në informatë publike, data 16 korrik 2025.

SI KONTRIBUON ANALIZA E KDI-SË NË PËRMBUSHJEN E OBLIGIMEVE NGA MSA DHE AGJENDA E GJELBËR

Duke qenë se Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025 (Shtojca: Kontributi i jashtëm në Draftin e Rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025)⁴⁰ kontrbuojnë dhe janë të lidhura ngushtë me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përkatësisht me nenin 115 për mjedisin, nenin 116 për ndryshimet klimatike dhe nenin 117 për mbrojtjen civile, si dhe me Agjendën e Reformave Evropiane (ERA) dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, analiza e KDI-së kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të këtyre dokumenteve strategjike.

Përmes fokusimit në tri impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura në Prishtinë, Mitrovicë dhe Podujevë, analiza e KDI-së synon të paraqes gjendjen reale dhe rëndësinë e përshejtitimit të reformave mjedisore dhe të adresojë mangësitë që pengojnë implementimin e standardeve të Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave sidomoos në kompeltim të kornizës ligjore dhe infrastruktururore.. Ajo ndihmon në matjen e progresit të Kosovës drejt përputhjes me acquis communautaire, veçanërisht me Direktivën Kornizë për Ujërat (2000/60/EC) dhe Direktivën për Ujërat e

Zeza Urbane (2024/3019/EC), duke identifikuar boshllëqet ligjore, institucionale dhe infrastruktururore që kufizojnë trajtimin efektiv të ujërave të ndotura.

Në këtë mënyrë, analiza përforcon kuadrin ndërkombëtar të bashkëpunimit dhe llogaridhënies, duke i dhënë institucioneve publike dhe partnerëve zhvillimorë një pasqyrë të qartë mbi sfidat dhe mundësitë ekzistuese për investime strategjike në këtë sektor. Ajo kontribuon në zbatimin e shtyllës 2.3 të ERA-së, që ka në fokus reduktimin e ndotjes së ajrit dhe ujit dhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave, si dhe në avancimin e objektivave të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor që synon kalimin drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe klimë neutral.

Përmes kësaj analize, KDI jo vetëm që ofron një instrument të matshëm për vlerësimin e përparimit të Kosovës në sektorin e ujërave, por edhe nxit një qasje më të integruar dhe të koordinuar ndërinstitutionale, duke e pozicionuar trajtimin e ujërave të ndotura si një prioritet shtetëror në procesin e integritimit evropian dhe në përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.



Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023–2027 dhe Plani i Veprimit 2023–2025 janë ngushtë të lidhura me zbatimin e MSA-së (nenet 115–117), Agjendën e Reformave Evropiane (ERA) dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

40 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025. SHTOJCA 3: Kontributi i jashtëm në Draftin e Rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025, faqe 49. Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2023. E qasshme në: [*ActDetail.aspx](#)

GJETJET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR IMPIANTET E TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA NË MITROVICË, PRISHTINË DHE PODUJEVË

- 89% e ujërave të ndotura në Kosovë derdhen ose përfundojnë në lumenj, pa asnjë trajtim, duke shkaktuar ndotje të vazhdueshme, degradim të ekosistemeve dhe ndikim në shëndetin publik.
- Projektet për ndërtimin e impianteve përcillen me mungesë të theksuar të transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha fazat: nga proceset planifikuese, të dizajnit, fazave përgatitore e deri tek zbatimi.
- Objektivi i vendosur në Projektligjin për Buxhetin e Shtetit 2025 për përfshirjen e 45% të popullsisë në sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura është i paarrtshëm në kushtet aktuale, duke pasur parasysh ecurinë e projekteve për ndërtimin e impianteve.
- Zhvillimi i infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura në Kosovë vazhdon të mbështetet kryesisht në financime të jashtme, përmes granteve dhe kredive nga partnerët ndërkombëtarë, duke

reflektuar një mungesë të vullnetit dhe kapaciteteve të brendshme financiare për investime kapitale në këtë sektor.

- Tre impiante të mëdha që janë planifikuar të ndërtohen në Prishtinë, Mitrovicë dhe Podujevë sipas projektligjit për buxhetin e shtetit 2025, janë ende në fazat fillestare ose përgatitore të projekteve.
- Vonesat në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave në Prishtinë dhe Mitrovicë jo vetëm që rrezikojnë zvarritjen e arritjes së objektivave kombëtare për trajtimin e ujërave të ndotura, por mund të shkaktojnë edhe pasoja të drejtpërdrejta financiare për buxhetin publik.
- Mungesa e bashkëpunimit të qartë të kompetencave ndërmjet institucioneve për tre impiantet (Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë) ka rezultuar në mungesën e koherencës së të dhënave për të njëjtat projekte, duke krijuar konfuzion në raportim dhe monitorim.

- Kompanitë Rajonale të Ujësllësit (KRU-të) janë ngarkuar me përgjegjësi të reja që lidhen me menaxhimin e impianteve, por kapacitetet teknike dhe administrative të tyre mbeten të kufizuara dhe të pamjaftueshme për të përmbushur këto funksione në mënyrë efektive.
- Mungesa e strategjisë kombëtare për menaxhimin e llumit dhe energjinë nga biogazi po ndikon në mënyrë negative në funksionimin e qëndrueshëm të impianteve – çështje kjo e adresuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

- Qeveria e Kosovës, trajtimin e ujërave të ndotura duhet t'a vendosë si prioritet strategjik kombëtar. Kjo kërkon angazhim për sigurimin e një financimi të qëndrueshëm nga buxheti vendor, duke reduktuar varësinë afatgjatë nga donacionet dhe kreditë ndërkombëtare. Një planifikim buxhetor proaktiv do të krijonte bazën për zbatimin sistematik të projekteve të impianteve.
- Të vendosen baza për harmonizim dhe koordinim ndër-institucional të veprimeve për të parandaluar mbivendosjen e kompencave, shmangur vonesat dhe për të siguruar efikasitet në realizimin e projekteve të impianteve.
- Të prioritetizohet harmonizimi i kornizës ligjore për menaxhimin e ujërave me direktivat e Bashkimit Evropian për ujërat për të përafëruar standardet për trajtimin e ujërave, mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve ujore me ato të BE-së.
- Qeveria dhe institucionet përgjegjëse duhet të intensifikojnë bashkëpunimin dhe avokimin të zgjerojnë bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë dhe agjenci zhvillimore, me qëllim të sigurimit të mbështetjes teknike dhe financiare për sektorin e ujërave, duke përfshirë zgjerimin e rrjeteve të kanalizimit dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në zona të tjera të vendit.

REKOMANDIMET SPECIFIKE PËR IMPIANTIN NË PRISHTINË, MITROVICË, PODUJEVË

- ▶ Të përshpejtohet zbatimi i projekteve për ndërtimin e impianteve në Prishtinë, Mitrovicë dhe Podujevë. Është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të jenë transparente dhe të vendosin afate realiste dhe plane të detajuara të punimeve, të shoqëruara me një mekanizëm të rregullt monitorimi dhe raportimi, me qëllim që projektet të mos mbesin për një kohë të pacaktuar në fazën përgatitore.
- ▶ Institucionet përgjegjëse përfshirë Kompanitë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" dhe "Mitrovica" dhe Ministrinë e Ekonomisë, duhet të publikojnë të dhëna periodike për ecurinë e zbatimit të projekteve për ndërtimin e këtyre 3 impianteve, për të garantuar llogaridhënie publike dhe fuqizuar monitorim qytetar.
- ▶ Impianti në Prishtinë: Të përfundohet projekt-dizajni dhe tenderimi brenda 2025, duke caktuar qartë përgjegjësitë mes institucioneve dhe kontraktorëve dhe të vazhdoen punimet duke respektuar të gjitha afatet kohore.
- ▶ Impianti në Mitrovicë: Të përfundojë procesi i përcaktimit të lokacionit brenda afatit të vitit 2025, për të mundësuar hapjen e tenderëve në 2026 dhe të vazhdoen punimet duke respektuar të gjitha afatet kohore.
- ▶ Impianti në Podujevë: Qeveria dhe Kuvendi të përshpejtojnë ratifikimin e marrëveshjes, ndërsa KRU Prishtina të fillojë përgatitjen e dokumentacionit teknik paralelisht dhe të vazhdoen punimet duke respektuar të gjitha afatet kohore.

